

## U zhvillua ceremonia e dorëzimit të Katalogut të Standardeve Shqiptare në Bibliotekën e Universitetit Politeknik të Tiranës

Më datën **18 Shkurt 2015**, ora **11.00**, në kuadrin e përfshirjes së Edukimit në fushën e Standardizimit dhe zgjerimit të bashkëpunimit me Universitetet, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) realizoi një takim në ambientet e Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT).

Në këtë veprimtari, nga DPS morën pjesë Z. Riza Hasanaj - Drejtori i Përgjithshëm, Znj. Kostanca Dedja – Drejtore, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënies me Palët dhe Znj. Anita Reçi - Specialiste në Sektorin e Promovimit dhe Marketingut. Nga UPT ishin të pranishëm, Z. Genci Sharko - Pedagog dhe anëtar i Bordit Teknik të DPS, Përgjegjësi e Bibliotekës dhe studentë të vitit të Dytë Master në Fakultetin Elektrik.

Bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT) ka qënë shumë i mirë dhe i vazhdueshëm, përmendim këtu:

- bashkëpunimin në nivel drejtues - përfaqësues nga UPT janë antarë të bordit Drejtues të DPS-së;
- bashkëpunim në nivel teknik – pjesëmarrës në Bordin Teknik si dhe Anëtarë e Kryetarë të Komiteteve Teknike të DPS-së.

### Dorëzimi i Katalogut të Standardeve Shqiptare në Bibliotekën e UPT-së



Fillimisht u vizitua Biblioteka e Universitetit, ku u dorëzuan disa kopje të Katalogut të Standardeve Shqiptare në format letër dhe elektronikisht (CD) duke iu ardhur më pranë studentëve me informacion mbi standardet.

Katalogu i Standardeve Shqiptare është botimi më i rëndësishëm vjetor në lidhje me standardet, lidhur me statusin e standardeve dhe përmban arkivën e standardeve shqiptare të klasifikuara sipas subjektit dhe fushës që mbulojnë, si dhe standardet e shfuqizuara.

### Takimi me studentët

Në një nga auditorët e UPT-së u zhvillua një takim me studentët e Fakultetit Elektrik, gjatë të cilit u bë edhe një prezantim në fushën e standardizimit, nga Znj. Kostanca Dedja.

Prezantimi ishte organizuar në formën e një FAQ (Pyetje/Përgjigje të shpeshta) duke iu dhënë përgjigje pyetjeve; Çfarë është një standard? Çfarë bëjnë standardet për Ju? Si mund të blini një standard? Si mund të blini një standard? A aplikon DPS ulje në çmimin e standardeve? etj.

Një shembull standardi u paraqit për të kutpuar më mirë pamjen, strukturën e standardit, termat dhe respektimin e të drejtës së autorit etj.

Në fund të prezantimit studentët u njohën me publikimet e DPS, materiale këto që mund t'i ndihmojnë gjatë procesit të studimit apo edhe në zhvillimin e temave të diplomës në këtë fushë.

Gjithashtu, DPS prezantoi të gjitha mjetet e komunikimit në dispozicion (tel, fax, faqja e internetit, Profilet e DPS-së në mediat sociale) dhe shërbimet që ajo ofron.



Studentëve, në përfundim të takimit, iu shpërndanë kopje të publikimeve; Rreth DPS (misioni, organizimi, publikime e rëndësishme, kontakte etj), botime mbi rëndësinë dhe përfitimet nga përdorimi i standardeve dhe krijimin e përfitimeve nga standardet për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SME-të) dhe materiale promocionale.

**Më poshtë disa nga publikimet e DPS, shpërndarë gjatë takimit:**

**Fletëpalosje**

- “Standardet – Rreth DPS”;
- “Si të marrim pjesë në procesin e standardizimit”
- “Ju jetoni 24 orë me standarde”.

**Broshura**

- Përfitimet nga standardet;
- Standardizimi, një garanci më shumë për cilësinë dhe sigurinë e produkteve;
- Sistemet e Menaxhimit Mjedisor për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme;
- Udhëzuesi i Menaxhimit të Shërbimeve;
- Standardizimi për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme.